



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 21/11/2017

TAKIM PËR BUXHETIMIN ME PJESËMARRJE ME BANORËT E NJËSISË
ADMINISTRATIVE VITHKUQ

Bazuar në Ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në vijim të procesit të përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2018, zhvilluam një takim në datë 21/11/2017 me banorët e Njesisë Administrative Vithkuq.

Në takim morën pjesë: Zv/Kryetari i Bashkisë Kletjon Kita, staf i bashkisë, banorë të njesisë administrative Vithkuq dhe organizata të tjera të interesuara, për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat ku ata jetojnë.

Gjatë takimit banorët sollën në vëmendje dhe shqyrtuan së bashku disa kërkesa dhe problematika të zonës, të cilat janë të listuara si më poshtë:

- Rikonstruksionin apo ndërtimin e ujësjellësave në fshatrat e njesisë administrative Vithkuq.
- Rehabilitimin dhe sistemimin e rrugëve të brendëshme në fshatra.
- Vazhdimin e procesit për pastrimin e kanaleve kullues dhe vaditës në të gjitha parcelat.
- Sistemimin e rrugës hyrëse në fshatin Gjanç.
- Rikonstruksionin e lapidarit të dëshmorëve në Makërz, Vithkuq.

Buxhetimi me pjesëmarrje është një mekanizëm që lejon qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrje dhe ngritjen e transparencës në procesin e hartimit të buxhetit.











